

VENDIM
Nr. 5952, datë 30.10.2018

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, *“Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”*, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 10, datë 4.8.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit **“Kurt Aruçi”**, protokolluar me nr. 4128 prot., datë 8.8.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 1/“q”, të nenit 38, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, *“Për pyjet dhe shërbimin pyjor”*. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2012, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 10, datë 4.8.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 80.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “Kurt Aruçi” ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.